



KADINA

Ballina: Kadina Je



Kush është
Kadina Je?





SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend



ANTALYA | TÜRKİYE



SHERWOOD
Gölkaya Resort



SHERWOOD
Gölkaya Lara



SHERWOOD
Dünya Resort



SHERWOOD
Pinarlı Resort



3UE
Türkiye
Seyahat



GREENWOOD
Kızıllı Resort



GREENWOOD
Kızıllı Resort

sherwoodhotels.com.tr | greenwoodhotels.com.tr

+90 444 86 07



Ku është Sheron Stone e Kosovës?

Aktorja e famshme, Albulena Kryeziu, ka vite e vite që është në skenë. Sukseset e saj në aktrim janë të pamohueshme. Një kohë ishte shumë aktuale me rolin kryesor në serialin "Stinë dashurie", serial që me shumë interesim u ndoq në Kosovë. Por, ka kohë që nuk e shohim në skenë! Hë, pse?

Flash

Ku është "kryetari" që i ironizonte të gjithë?!

Kryetari Legjendar i Partisë së Fortë, Visar Arifaj, i lindur në vitin 1987, dikur i jepte kosës haptë!
Por, sharra i hasi shpejt në gozhdë, meqë, në kohën kur ishte asamblist në Komunën e Prishtinës, vazhdoi me politikën e ironizimit të gjithçkaje!
Mirëpo, turri i tij që i shkurt dhe shpejt u dorëzua!
Emri i tij më nuk përmendet as për të mirë e as për të keq...



Hiqu politikës, po qysh me e gjet një vend pune!

Politizimi i jetës në Kosovë tashmë ka arritur kulmin, por bren-gosin më së shumti rastet e vazhdueshme të vrasjeve, të sulmeve fizike, madje edhe në Parlament e gjetiu, siç ndodhi rasti me kryetarët e komunave, ar-ratisja e të burgosurve, dhuna e vazhdueshme e burrave ndaj grave, e të tjera të ngjashme...

BLIN HASANI, KAMERIER: ME POLITIKË PO MERRET GJITHKUSH!

- Jemi ngulfatur deri në fyt me politikë! Po merremi me përditshmërinë tonë: kush çka tha, kush kujt çka i tha, kush me kënd debatoi, e të tjera të ngjashme, që më shumë të nevrkosin sesa që mëson njeriu diçka nga ato thashetheme!

Thënë të drejtën, pata vendos të mos i përcjell debatet politike, por s'po mund të rri i heshtur para kësaj katrahure: dikush flet me kriminelin Radojiçiq, e thotë nuk kam folur, dikush i del në mbrojtje se ka qenë bisedë e montuar, dikush atë bisedë



e sulmon me të gjitha mjetet e mundshme demokratike, dikush...

Por, jetojmë në Kosovë dhe merremi me gjithçka!

Paramendojeni një të rinj amerikan, gjerman a francez, i moshës sime, të brengoset me politikë, siç ndodh me ne, shqiptarët e Kosovës?!

VIRTYT HETEMI, EKONOMIST: ÇKA PRESIM NGA ATA QË GRUSHTOHEN NË KUVEND?!

- Në Kuvendin e Kosovës, e më keq në Kuvendin e Shqipërisë, çdo ditë përplasje, fyerje e çka jo tjetër! Andaj, u bëj apel të rinjve të mos merren me politikë, ta largojnë vëmendjen nga politika dhe t'i kthehen shkollimit, studimeve, jetës pa brenge...

Thënë shkurt: Nuk dua që politika të jetë temë kryesore diskutimi ndërmjet të rinjve, por të diskutojnë për hallet e tyre, të ardhmen e tyre...

MIRANDA BAJRUSHI, E PAPUNË: QYSH ME E GJET NJË VEND PUNE?

- Nuk më ka ndodhur asnjëherë që në shoqërinë time me shoqe të mbizotërojë

politika.

E, kjo, për mendimin tim, është mirë. Sepse, ka disa vjet që e kam kryer Fakultetin Juridik dhe kurrë një vend pune nuk e kam gjet.

Një i njohur më ka ofruar të punoj një kafene të shokut të tij, por unë nuk jam shkolluar për kameriere!

Gjithë ato provime që i kam dhënë e të punoj në butik a kafene - hyj n'gjynah me shpirtin tim!

E, t'i kthehem temës për të cilën edhe më keni kontaktuar: Politikanët flasin, diskutojnë, kacafyten e përplasen ndërmjet veti, sepse m'u për ato gjëra edhe paguhen, madje marrin edhe paga të majme!

E, populli i shkret jeton me ndihma sociale, me pensione që me 20 për qind rritje është hajgare, e të mos i numëroj të gjitha se veç sa nevrkosem...

Sidoqoftë, të faleminderit që ma dhe rastin të shfryhem se s'po kam as me kë ta bëj bisedë problemin tim që jetoj e papunë...

PËR FUND

Pjesa dërrmuese e popullatës jeton në skamje, e ata që merren me politikë sa me një xhip e sa me një tjetër, sa në një ndejje e sa në një tjetër, sa në një shtet e sa në një tjetër...

Ky është realiteti ynë kosovar: bardh e zi!

Diturie Haxhaja



Çdo ditë nga një dhunim në Kosovë!

Kohëve të fundit është fol e përfol shumë për dhunimet që po ndodhin në Kosovë. Disa raste, si ai që ndodhi ditë më parë me 20-vjeçaren në Pejë, kanë kaluar çdo limit dhe janë vënë në pranga dhunuesit.

Kohëve të fundit kanë ndodhur aq shumë dhunime në Kosovë, sa që njeriu duhet ta pyes veten - çka po ndodh në këtë vend me kaq shumë dhunime?

A ka dorë këtu pedofilia apo ka dorë psikopatia njerëzore, që i duket se edhe sytë e të miturave nxisin botën e meshkujve të moshës së rritur dhe të shtyrë?

në parandalimin e veprave të tilla kriminale, që rrezikojnë jetën e të rejave, duke rënë viktimat të meshkujve të pamëshirshëm e pa ndërgjegje njerëzore. E, shteti, me masa ndëshkimore të ligjit në fuqi, duhet t'i analizojë shkaqet pse po ndodhin kaq shumë dhunime në Kosovë...

publike?

E, personeli shkollor duhet të luajë rolin edukativo-arsimor me veshje uniformë, për hir të mosnxitjes së situatave provokuese, edhe pse dhuna nuk ka arsytim dhe duhet të ndëshkohet me të gjitha mjetet e mundshme.

Diturie Haxhaj

KUSH DHE PSE PO DHUNOJNË NË KOSOVË?

Kjo pyetje duhet shtruar edhe te ekspertët psikiatrikë dhe te psikologët.

Megjithatë, diç është e qartë: lakmia ka dorë në këtë dukuri...

Por, pa hyrë në hollësi, dhunuesit në Kosovë duhet të marrin dënimin e merituar. Prokuroria dhe gjykatat duhet ta zbatojnë ligjin me përpikëri.

Zbatimi i ligjit, pa dyshim, do të ndikonte

KU JEMI ME EDUKATË FAMILJARE?

A ka vend për kritikë edukimi jo i mirë në familje?

A ka vend për kritikë moskujdesi adekuat prindëror ndaj të miturave, që në moshë shumë të reja fillojnë me bartjen e veshjes provokuese në vende



Nëse je pa rrogë merru me politikë!

Politizimi i jetës në Kosovë ka arritur kulmin, veçmas tash kur jemi në prag të zgjedhjeve, të cilat do të zhvillohen në shkurt të vitit të ardhshëm...

Populli i Kosovës, përkundër varfërisë së madhe, është ngulfatur deri në fytyrë me politikë!
Para do vjetësh, kur edhe ishim të robëruar, kam pas menduar se pas çlirimit nuk do i interesoj kujt kush çka tha, kush kujt çka i tha, e të tjera.
Por, po del e kundërta!
Mu tash, në kohën e sotme, në prag të zgjedhjeve që do të zhvillohen në shkurt të vitit të ardhshëm, më shumë se kurrënjëherë dëgjohen zëra ndaj njëri-tjetrit, ofendime të ndryshme që individë të caktuar u bëjnë të tjerëve - kundërshtarëve politikë!
Thënë shkurt, me politikë sot po merret gjithkush! Edhe analistë politikë që shesin mend si të gjithëdijshëm ka sa të duash! Janë mbushur programet

televizive me debate, nganjëherë edhe me përmbajtje neveritëse...
E, çka jo tjetër?
Por, t'i kthehem titullit të këtij shkrimi: "Nëse je pa rrogë - merru me politikë".
Pse e them këtë?
Çka më shtyn ta them këtë?
Deputetët tanë janë ata që më kanë motivuar ta mendoj këtë gjë.
Sepse, jo vetëm që marrin pagë të majme, por edhe mëditje e beneficione të tjera.
E, çka bëjnë?
Në seanca të Parlamentit shkojnë kur të duan!
Dalin kur të duan!
I sheh në shesh tek shëtisin sa herë që të duash.
Por, e keqja më e madhe, madje edhe

habitëse, është se seancat dhe komisionet e Parlamentit të ne, në Kosovë, më shumë i bojkotojnë ata që janë në pushtet sesa opozita!
Kështu, nuk besoj të ketë shtet në botë ku pushteti i bojkoton seancat e Parlamentit si të ne, në Kosovë, ndërkaq opozita merr pjesë dhe mundohet të bëjë ndonjë zgjidhje, edhe pse e ka vështirë të bëjë gjë, sepse i mungojnë votat dhe nuk mund të merren vendime.
Thënë shkurt: Merru me politikë nëse dëshiron të kesh jetë të mirë, pagë të mirë, mëditje të mira, dreka e darka derisa të ngopsh...
Dhe, çka jo tjetër?!
Biznes, se jo mahi!

Isa ILAZI

SHPIRTI ME VULLKAN!



Kriza ekonomike e ka bërë të veten: papunësi e madhe, skamje, varfëri, dëshpërim, zhgënjim i madh. Përditshmëri me stresse, me ngarkesa të mëdha.

Të gjitha të këqijat me sasi të madhe, pos shpresës dhe perspektivës që kanë mbetur të vogla - për ditë më të mira...

Dhe, në këtë krizë, fjala më e shpeshtë, e cila dëgjohet e flitet kudo që jemi, është paraja. S'ke para - s'ke kurrë!

Shpresëmbajtësi thotë: Veç shmeta është me rëndësi!

Tjetri thotë: Pa para as shëndet s'ke!

Cili e ka mirë e cili keq?

*

Gjërat më të bukura, por edhe më të dhembshmet në jetë, nuk shihen nëpërmjet syve. Ato ndihen nëpërmjet zemrës, shpirtit...

Edhe njerëzit janë si hëna: E kanë një anë prapa, të cilën ne nuk e shohim, nuk ia tregojnë kurrë askujt... Atë anë e njohin vetëm ata vetë...

Çdo kush mund t'u bëjë të lumtur kur bën diçka të veçantë, por edhe vetëm dikush i veçantë mund t'u bëjë të lumtur pa bërë asgjë.

Andaj, bëhu arsyeja e dikujt për ta bërë që të buzëqeshë: Krijvoja, falja në çast që të ndjehet i lumtur a e lumtur...

Femrat janë gënjeshtare: Të thonë "të urrejë"

teksa të duan me shpirt!

Meshkujt janë mashtrues: Të thonë "jam mirë, kurrë më mirë", ndërkaq në shpirt kanë prush, zharavë, vullkan!

Thonë: Kurrë mos hiq dorë nga dashuria!

Hiq dorë nga njerëzit që nuk dinë të të duan!

*

Secili e ka jetën e vet: të mirë a të keqe, të varfër a të begatshme, të dhembshme a të lumtur...

Secili e ka tregimin e vet të jetës.

Secili i ka përjetimet e veta.

Momentet e veta, dashurinë e vet, kujtimet e veta... Askush s'mund të ta njohë shpirtin a zemrën tënde më shumë se që e nje ti vetë.

Askush s'mund të ta njohë mendjen as synimin seç e njehë dhe e di ti vetë...

Kishte thënë njëri se ta gjykoshe jetën a karakterin tim, mbathi këpucët e mia dhe ec, kalo rrugën që kalova unë:

Jetoje skamjen time!

Përrjetoje lotin tim!

Qeshjet e mia!

Dashurinë time!

Jeto vitet që jetova unë!

Rrëzohu aty ku rashë unë!

Ngrihu siç bëra unë!

Ç'të thuhet tjetër?

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILLI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILLI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

Denisa Oruqi

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Gani Dili

Pse përmeden fjalët e Tahir Berishës së Malishevës?

Në shekullin e kaluar, shumë vizionar ishte Tahir Berisha, nga fshati Berishë i Malishevës. Ai kishte parashikuar se fshati i tij nuk do të pushtohej asnjëherë. E, kështu edhe ndodhi, pa varësisht tentimeve të forcave serbe që ta pushtojnë fshatin...

PSE BERISHA U BË CAK I BOMBARDIMEVE TË VAZHDUESHME?

Më 4 janar të vitit 1999, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së themeloi radion e luftës brenda një bunkeri. Selia e saj ishte në Berishë. Andaj, sulmet serbe drejt Majës së Pallanikut, ku edhe ndodhej bunkeri i radios, u intensifikuan.

Kështu, ka pasur dhjetëra tentime të ushtrisë jugosllave të ngjiten në Berishë,

por të gjitha ishin të pasuksesshme, sepse ishte UÇK-ja që u përball me ta.

Sidoqoftë, fatin e këtij fshati, që dikur kishte afër 40 shtëpi, e kishte parashikuar edhe një nga vizionarët më të mëdhenj shqiptar.

E, ai ishte Tahir Berisha, nga fshati Berishë i Malishevës.

Ai kishte thënë se Berisha nuk ishte pushtuar kurrë e as nuk do të pushtohej.

Tahiri ka qenë vizionar, i mençur dhe i ka ditë të gjitha...

Çka ka thënë Tahir Berisha kanë dalë krejt...



Tahir Berisha nga Berisha (1871 – 1953)



Pamje e fshatit Berishë të Malishevës

SHKURT E SHQIP: KUSH ISHTE TAHIR BERISHA?

Tahir Berisha ka pasur autoritet në popull. Kishte qenë kryetar i Komunës së Malishevës dhe gjithmonë i kishte fituar votat. Kishte qenë në lidhje me kaçak, konkretisht me Azem Bejtën.

Tahir Berisha e ka ditë çfarë ka shkuar, por edhe çfarë do të vijë...

Por, edhe pse Berisha nuk u pushtua asnjëherë, nga granatimet e vazhdueshme serbe u vra nxënësi Elbasan Berisha, më 27 mars të vitit 1999.

Kush është Kadina Je?

Kadina Je, ky është emri i një gruaje të fortë, të jashtëzakonshme, ambicioze e të pashme.

Jeta e saj nuk ka qenë “fushë me lule”, por ia ka dalë të triumfojë mbi çdo sfidë, duke e lartësuar emrin e saj në stadin e ëndërruar gjithmonë.

Kadina është pronarja e vetme e një prej parfumeve më viral të momentit “Maison Kager” dhe firmës së madhe të bukurisë e estetikës “Lapis Beauty”.

Për rrugën e jetës, flasim me zonjën që emrin e saj e ka shndërruar në brend...





Kush është Kadina?

- Jam një femër e lidhur ngushtë me botën e biznesit dhe atë të bukurisë. Ambicioze, por deri në atë pikë sa ambicia ime të mos më dëmtoj as mua dhe asnjë njeri ose rrethanë të mundshme. Jam nënë e dy fëmijëve, e divorcuar, por që ruaj raporte të shëndosha me ish-bashkëshortin. Jetoj dhe veproj në Zvicër.

Pra, jeni një "mami single"?

- Isha e martuar me babanë e fëmijëve të mi. Jemi divorcuar, por kemi raporte tejet të mira, meqë kishim ndërtuar një jetë bashkë. Ai ka bizneset e veta, ama gjen përherë hapësirë për ta ndihmuar edhe zhvillimin më të favorshëm të bizneseve të mija. Gjithsesi, jam një mami plotësisht "single" dhe e lumtur.

Biznesi juaj "Lapis Beauty" është tejet i njohur. Si ia dole?

- "Lapis Beauty" është biznesi në të cilin kam investuar shumë mund, punë dhe dashuri. Në qendër të biznesit është bukuria dhe estetika.

Çka do të thotë "Lapis"?

- Lapis është emri i një guri të çmuar natyral që ka ngjyrë të kaltër, i cili njihet për forcimin e shoqërisë, për të vërtetën, besimin dhe qetësinë shpirtërore.

Për ju, personalisht, ka një domethënie speciale?

- Unë jam boshnjake dhe besoj shumë në Zot. Guri Lapislazuli më lidhë edhe më





shumë me vendlindjen dhe besimin tim. Nuk kishte dhe nuk mund të ketë një emër tjetër më domethënës dhe që i përshtatet më tepër karakterit tim.

Cila është gama e produkteve që sjell "Lapis"?

- "Lapis" ka prodhuar produkte për flokë, fytyrë, lëkurë etj.

Parfumi i parë i lansuar në treg ishte për flokë, që quhet "Kadina". Aktualisht i kemi 20 produkte ekskluzive në www.lapis-shop.ch.

Shampot, kremrat dhe parfimet janë në dispozicion për një klientelë të gjerë në të gjithë botën, meqë brendi është internacional.

Kadina, në rrjete sociale flitet shumë për parfimet e krijuara nga ju?

- Projekti më i madh është parfumi "Kali". Në këtë parfum për dhjetë vjet kam investuar gjithë potencialin tim dhe rezultati është fenomenal.


Projekti tjetër që është në finalizim është parfumi "Kismet", një aromë ekstravagante për femra.

Është tejet ekskluziv dhe mezi po presë të dalë në treg.

Jeni pronare e parfimit bestseller e shumë të famshëm "Maison Kager"?

- Po, unë dhe firma ime "Lapis Beauty" jemi pronarët e vetëm të parfimit "Maison Kager".

Patenta e parfimit është në emrin tim. "Maison Kager", "Kali" dhe të gjitha parfimet që do të vijnë janë plotësisht pronë imja.





Në rrjete sociale ka pasur propagandë të ndryshme, meqë parfumi është "promovuar" nga persona të cilët unë nuk i kam angazhuar. Gjithsesi, faleminderit që e promovojnë parfumin tim pa pagesë (qesh)! Versioni origjinal i "Maison Kager" gjendet vetëm në www.lapis-shop.ch. Të tjerët nuk janë origjinal dhe nuk kanë të bëjnë me mua. Shumë shpejt "Maison Kager" do të shitet edhe në "Prishtina Mall" dhe disa pika të tjera.

A keni në mendje ndonjë imazh që do të bëhet fytyra e "Maison Kager"?

- Në mendjen time janë dy persona që i shoh si fytyra të brendit tim të parfumeve "Maison Kager". E, ata janë Azem Gagica dhe Oriola Marashi. Që të dy janë imazhet perfekte që do ta përfaqësonin më së miri energjinë e "Maison Kager". Azemi është fytyra mashkullore që i përshtatet më së miri parfumit, ndërkaq Oriola me sensualitetin, bukurinë dhe elegancën do të ishte përfaqësimi më i denjë i "Maison Kager".





Definitivisht, Oriola është e vetmja femër shqiptare në botë që e plotëson imazhin e parfumit tim. Si Azemi ashtu edhe Oriola janë të bukur për brenda dhe jashtë.

Pra, deri më tani askush nuk është angazhuar si fytyrë zyrtare e parfumit?

- Jo, askush. Oriola dhe Azemi më flenë në zemër dhe më përshtaten.

Kam shumë oferta nga fytyrat publike, por nuk kam vendosur ende asgjë se kush do të jetë partneri im i biznesit në Kosovë.


Në fund, a do t'i thuash dikujt faleminderit për diçka?

- Jam rritur pa baba dhe me kushte mjaft të vështira. Meqë fëmijërinë e kisha të vështirë, jam munduar të bëj çmos që të arrij suksese të mëdha, në mënyrë që t'i mundësoj nënës dhe familjes sime një jetë më të mirë.

Mundi im shumëvjeçarë është shpërblyer, andaj e falënderoj veten, familjen, por edhe nënën dhe ish- vjehrrën time për kujdesin për fëmijët e mi.

Dhe në fund një falenderim të veçantë për asistenten time personale, Ari Uruqi.

Nderim Neziri



Pamje nga gjykimi i Ferat Mujës

35 vjet në kërkim të varrit të babës!

Kisha dëgjuar shumë herë se sa më shumë që plaket njeriu, më lehtë i dalin lotët...

Isha i vogël kur babai u sëmur. Pak ditë para se të ndërronte jetë e kërkoi babën e vet. Ishte rritur jetim.

Unë, që e kisha shpirtin lidhur me nënën, i bëja vetes pyetje se si babai kurrë nuk fliste për nënën e tij.

E, se ka diçka që lëviz ndërmjet babait dhe djalit, më bindi një ditë në Gërmi, mu para shtëpisë protokollare që e nisi ta ndërtonte Nexhat Daci, por që prej largimit të tij nga pozita e kryeparlamentarit më nuk u vazhdua!

KUSH E KËRKON VARRIN E BABIT 35 VJET?

Se ka një shpirt fantazmë ndërmjet babait dhe djalit, u binda kur u takuam me Asllan Mujën, para 5 vjetësh.

I tregova se kisha dëgjuar që babanë e tij e kishin pushkatuar në Gërmi.

Por, ende pa i përfunduar fjalët u ngrit të nisej për atje...

"Prit ta them tërë rrëfim!", i thashë.

Por, nuk pat durim. Tha se varrin e babait

po e kërkonte që 35 vjet, e nuk po e gjente askund mbi tokë...

"A MU DUK KRISI NJË PUSHKË?!"

Kur i biri i Ferat Mujës së pushkatuar para më shumë se 35 vjetësh futi duart nën dushkun e malit të Gërmisë ta kërkonte varrin e babait, të cilit ia kërkoi eshtrat që tri dekada e gjysmë, tha: "A mu duk krisi një pushkë?!"

Në fakt, nuk kishte asnjë krimë, por ishte te vendi ku regjimi i kohës ia pushkatoi babanë pas një gjykimi maratonik, në të cilin kishin dorë Nikolla Lubiçiçi e Kolë Shiroka, me Kapllan Barutin prokuror dhe gjyqtar Ismet Emrën, që i shqiptuan vendimin.

KUSH ËSHTË ASLLAN MUJA?

Asllan Muja është djali i dytë Ferat Mujës, me prejardhje nga Bajgora e Shalës së Mitrovicës.

Ata ishin shpërngulur në fshatin Samadrahë të Vushtrisë prej vitësh.

Ishte viti 1982. Ferat Muja ishte pensionuar si minator i "Trepçës" dhe shkoi në Vushtrri ta merrte pensionin.

Me vete e kishte djalin, Xhaferin, e nipin Safet Sinanin.

Dhe, teksa kalon pranë shtëpisë së Miliçiçëve, një rrugë këmbësorësh që nuk ishte ndalur kurrë, i suloi Danilo Miliçiçi (22 vjeç) me shati në dorë!

E, në atë kacafytje, Ferat Muja nxjerr revolen dhe e lë të vdekur afër shtëpisë së tij. Por, për Danilon viti 1982 ishte viti i fundit i jetës, ndërsa për Feratin viti i fillimit të mundimeve, e ku pas dy vjetësh regjimi i kohës e dënon me pushkatim, sepse rasti u politizua shumë...

Mbrojtjen e Ferat Mujës e kishte bërë avokati guximtar Bajram Kelmendi, i cili e kishte konfirmuar sa e sa herë se i kishin hyrë në hak Ferat Mujës që nuk kishin mundur ta mbronin nga dënimi me vdekje...

Dhe, dy vjet më vonë, Ferat Muja ishte pushkatuar! E, eshtrat e të vrarit nuk do t'i dorëzoheshin familjes 20 vjet!

Familja e Ferat Mujës mendonte se ai ishte pushkatuar në varrezat afër burgut të Mitrovicës dhe pas lufte kishin hulumtuar për ndonjë shenjë që mund të qonte në gjetjen e varrit të Ferat Mujës, por asnjë shenjë nuk ishte gjetur.

Pas shpalesjes së letrave të avokatit Bajram Kelmendi, doli se ai ishte pushkatuar në "Gërmi" të Prishtinës, në vendin "Shtëpia Protokollare e Parlamentit të Kosovës", e cila ende është e papërfunduar.

Safet Krivaça



anaderm

Abdomenoplasty

Largimi i lëkurës së tepërt në abdomen



Prof. Dr. Selahattin Özmen
Specialist i Kirurgjisë Plastike dhe Estetike



Rr. Zef Jubani – Veternik,
Prishtinë, Kosovë



+383 (0) 45 707 744
+383 (0) 43 707 744

Kush jeton mirë në Kosovë?

Ankesat e zyrtarëve kosovarë të politikës bien ndesh me gjendjen reale në terren. E, se është kështu, më kujtohet një storie e një burri me mustaqe të gjatë deri te veshët në kohën e grevës së minatorëve në Kosovë, që nisi në "Trepçë" dhe u përhapë në tërë Kosovën...

KOINCIDENCA E MINATORËVE ME POLITIKANËT TANË

1300 minatorë të "Trepçës", në vitin 1989, u futën në grevë urie në zgafellën nëntokësore të minierës, në mbrojtje të autonomisë së Kosovës, duke kontribuar në një rezistencë gjithëpopullore. Atëbotë, një storie e xhiruar nxirrte një mi-

nator grevist me mustaqe deri te veshët, duke i rënë të fikët në mesin e grevistëve... Pasi e shikova mirë, doli të ishte fqinji im, S., që natën vinte në shtëpi të flinte, e kah mëngjesi shkonte te shokët! Por, kjo nuk ishte në "Trepçë". Dhe, pas përmbylljes së grevës së minatorëve, me fqinjin tim u takuam rastësisht në rrugë dhe pranoi se nuk ishte alivanosur, por e kishte bërë qëllimisht për ta bërë më tronditëse gjendjen në Kosovë... Por, nejshe...

PA ASNJË CENT NË XHEP PI "MALBORO"!

Në mëngjes, ditë kur edhe e shkrova këtë shkrim, me të hyrë në kafene për makiato të mëngjesit, hyn një mesoburrë në moshë dhe ulet te shokët e tij të përherëshëm në tavolinë.

Ai nuk ka para, por nuk i kalon mëngjesi pa makiato e duhan. Si të tjerëve, kamerieri i sjell makiaton. Pi makiato dhe bën muhabet me shokë, pa lënë asnjë shenjë se nuk ka asnjë cent në xhep. Pas pak në kafene hyn një shitës cigaresh

me paketë në dorë, e atij i blejnë edhe duhan!

Shokë se jo mahi, them me vete... Po, ku ka kështu, pa asnjë cent në xhep, të të vije makiato mbi tavolinë e cigaret "Marlboro"?!

KU KA JETË MË TË MIRË SE NË KOSOVË?

E, kur dola nga kafeneja, me turr e marrë një tost për mëngjes dhe e pyes shitësin: Si je, si po kalon me punë?

"Ka mbet me thënë mirë, se shumë mirë jam! Punë sa të duash. Por, edhe fitimi besa i mirë...", ma ktheu dhe shtoi: "Nuk di pse po ankohen njerëzit?! Runa Zot nga propaganda! Po, ku ka jetë më të mirë se në Kosovë: Hanë e pinë pa bërë asnjë punë! Muhabet e muhabet sa të duash... Si të ulesh pranë tavolinës nisin debatet në stilin: ai e pat keq e tjetri mirë, ai bën e ai s'bën, e kështu me radhë..."

Askush nuk lodhet për asgjë! Edhe kur s'kanë cent në xhep, makiaton e kanë para vetes, duhan po!'

Euuu, them me vete...

S. Murturi

Edhe kjo po bëke vaki...

Nëna ma mori burrin!

Kurrë nuk do më kishte shkuar në mend një gjë që më ndodhi: Nëna, në vend që t'më gjente mua burrë, ma mori burrin...

Posa e kreu shkollën e mesme dhe u regjistrua në fakultet, fare spontanisht filloi jeta e dashurisë. Pikërisht, atë ditë kur nisesha nga shtëpia ime në fshat për në Prishtinë, ndodhi një e papritur në jetën time...

Kur arrita në Prishtinë, hyra në një butik që ndodhej afër stacionit të autobusëve dhe i shikoja veshjet, meqë veshjet që i kisha me vete nuk ishin për fakultet.

Shitësi, një mesoburrë, më tha:

"Ke ardhur për studime, a?"

"Po", ia ktheva.

"Je nga ndonjë fshat i largët, a?"

"Po", i thashë, paksa me zor, sepse nuk doja ta vazhdoja muhabetin.

"Shiko zonjushë, unë si pak më i vjetër se ti, të jap një këshillë, sepse po ngurron të flasësh, e në qytet s'ka ngurrim", më tha.

"Të faleminderit, më vjen mirë që kemi njerëz të tillë si ti!", ia ktheva, më shumë për ta përmbyllur muhabetin.

"Me nderë qofsh, por ngjitas lokalit tim është një restorant dhe do na bënte mirë nga një kafe bashkë", më tha.

PAS NJË ORE - NË SHTRAT!

Posa i pimë kafetë, muhabeti na shkante mirë. Ndërkohë, një nxehtësi ma përshkonte trupin.

Dhe, teksa bisedonim, biseda ndërronte kahun...

E, kur veç pashë se biseda jonë do të hyjë llugave, i dhashë të ngrihem.

Ndërkohë, u ngrit edhe ai.

Pagoi dhe dolëm nga restoranti.



Kur ia zgjata dorën të përshëndeteshim, më tha: "Jo, nuk do të shkosh pa marrë diçka në butik!".

Dhe, pa një e pa dy u ndodha në udhëkryq: Të hyja edhe një herë në butik a jo?!

E, pas një hamendjeje të shkurtër, shitësi e hapi butikun dhe unë pas tij hyra brenda. I shikoja bluzat, fustanet, xhinset në raftet...

M'i ofroi një parë xhinse dhe më tha:

"Këto po bahen tash. Hyrë në kabinë dhe provoj!".

Në kabinë hoqa fustanin që e kisha në trup dhe i vasha xhinset.

Vesha edhe një bluzë të hollë që e kisha me vete dhe dola nga kabina, qëllimisht që ta shikoja veten në pasqyrën e madhe që ndodhej në butik.

Dhe, teksa e shikoja veten, mu afrua shitësi e më tha: "Të rrinë bukur! Ama shumë bukur!" dhe më preku në bel, duke më thënë se numri është tamam për ty..

Mirëpo, mu ajo prekje e tij m'i zgjoi ndjenjat.

Të dridhura ma përshkuan trupin...

E, shitësi e hetoi shqetësimin tim... Shpejt eci kah dera e butikut, e rrotulloi çelësin dhe e kyçi derën.

M'ua afrua afër dhe m'i preku flokët.

Ndërkohë nisa të djeritesha...

Dhe, ngadalë i afro buzët e tij afër të miave dhe më puthi...

E, puthje pas puthje më shtriu në dysheme dhe m'i hoqi xhinset, pastaj të brenshmet...

PREJ LUMTURISË TË PIKËLLIMI E NDARJA...

Pas dy javësh, kur u ktheva në fshat, nëna hetoi shqetësimin tim dhe më tha:

"Paskë gjetur burrë, a?"

"Po. Por, mos i trego motrës së madhe se mund të bëhet xhelozel!", ia ktheva.

"Kam me ardhur me ty në Prishtinë se dua ta njoh!", më tha.

Dhe, ashtu ndodhi...

Të hënën në mëngjes, bashkë me mua edhe nëna udhëtonte për në Prishtinë. Kur arritëm te butiku, në derë ishte ai, ai që më rrëzoi në dysheme që në ditën e parë që më pa.

E njoftova me nënën.

Dhe, si e kishte ai zakon, nga ai njoftim shkuam të pimë kafe në restorantin afër butikut të tij.

E, teksa bisedonim, pashë se nëna shpesh ia ngulte sytë.

E mendova: Ka vite që e shkreta ka mbet pa babën tim, pa burrë...

Sidoqoftë, pas 1 viti u martova.

Në muajin e dytë të martesës e vërejta se diçka nuk ecte mirë. Ai kërkonte të shkonim shpesh në fshat.

Pse? – e pyesja veten.

Pas një kohe më tha se do të shkante për një 3-4 ditë në Stamboll për të marrë mall.

"Ani, ti i di punët tua!", i thashë.

Dhe, ditën që shkoi e kalova e vetme në banesë.

Të nesërmen u mërzi ta që ai nuk ishte në shtëpi dhe i hipa autobusit e drejt e në fshat.

Hyj në shtëpi, nëna s'ishte askund!

"Ku është nëna?", e pyeta motrën e madhe, meqë ende ishte e pamartuar dhe jetonte me nënën.

"Ka shkuar te dajallarët", më tha.

Dhe, pa një e pa dy u nisa në këmbë të shkoja te dajallarët, në fshatin afër nesh.

E, kur arrij te ta, as aty nuk ishte...

"Heu, thashë me vete, paska shkuar në Stamboll me tim burrë!"

Andaj, meqë dyshja në një gjë të tillë, vendosa ta prisja derisa të vinte.

Në ditën e katërt, pak para muzgut, u dëgjua një zhurmë veture para dyerve të oborrit.

Vrapova shpejt e dola te dera.

Nga vetura doli nëna ime!

"U marroftë Zoti!", u thashë të dyve dhe u ktheva të hyja brenda, sepse më nuk doja t'i shihja asnjërin me sy...

Vezirja

Pse po ua kthejmë shpinën kurbetçarëve?!

Kurbetçarët janë kënga dhe vaji i popullit tonë. Ata na kanë mbajtur gjallë dhe e kanë zbutur varfërinë e popullit.

Në vitet 70 askush nuk është bërë kurbetçar nga dëshira, por nga zori për bukë, për jetë më të mirë. Ishte varfëri. I mbaj mend shtëpitë me çati kashte thekre. Ai që e kishte çatinë me tjegulla, ishte i përmendur...

Në vitet 70 komunikimi i atyre që shkonin në kurbet me familjen bëhej me letra. Kur arrinte letra nga jashtë, së pari, e shikonim datën kur ishte nisur. Letrat udhëtonin me nga një javë a dy, varësisht nga vendi. Zakonisht, letra i referohej babait, si kryefamiljar shtëpie apo vëllait më të madh.

Kurbetçarët kishin mall për çdo kë në mëhallë, në fshat dhe pyesnin për gjithsecilin. Populli i donte, sepse kishin shkuar për bukë goje në vende të ndryshme të botës, prej një treni në trenin tjetër.

Dhe, për gjithë këtë, më së miri flasin vargjet: "Nënë Kosovë

Në këtë kurbet të zi S'po teren sytë e mi!"

SOT NË KURBET SHKON EDHE AI QË S'KA NEVOJË!

Në atë kohë ishte adet që kur vinte kurbetçiu, të shkonin fqinjët ta vizitonin dhe t'i uronin mirëseardhje në familje.

E, kurbetçiu, si adet, ua jepte një pako cigare, ndonjë shkrepse a gjësend tjetër në shenjë nderimi...

Në ato raste, shtëpisë i shtoheshin mysafirët, jeta në familje bëhej më dinamike... E, kur kurbetçiu kthehej në vendin ku jetonte, derdeshin lot, sepse largësia të rrëqethte deshe a s'deshe...

E, sot gjithçka është ndryshe: Vijnë e shkojnë kurbetçarët e pakkush nga farefisi i pret ata, sepse numri i tyre është bërë i madh, e shumëkush ja therr nëpër botë pat nevojë apo nuk pat!

S. Krivaça



MARINA

Fall Experience

Indulge in a cozy getaway, and exciting entertainment this autumn

Starting from
ALL **17.400** 2pax

INCLUDING:

BREAKFAST & DEGUSTATION DINNER
SIGNATURE COCKTAILS
CASINO TICKET & -20% MASSAGE

For more info & Reservations

Rr. "Aleksandër Moisiu", Vlorë, Albania | +355 69 604 1000 | info@marinabay.al

“Good Girl” - Sindromë është priorizimi i nevojave të të tjerëve mbi nevojat tuaja

“Sindromë” e re në psikologji, por jo te ne si shoqëri...



Rrallë mund të përcaktohet një shkak specifik kur është në pyetje depresioni.

Mirëpo, unë prapë kam zgjedhur të shkruaj për një ndër shkaqet që psikologjia assesi nuk e përjashton, përkundrazi e miraton.

Një kategori e madhe e njerëzve që bien në depresion janë, zakonisht, persona të cilët ishin dhe janë shumë të mirë ndaj të tjerëve dhe kanë harruar ndër vite edhe vlerën

e tyre, e sidomos kujdesin për veten.

Pleqnarët tanë thoshin për këta njerëz: “E mira e hallkut - e zeza e vetit!”.

Mirëpo, si normë edukimi vazhdonte prapë të mbizotëronte vlera e vetëflijimit, vlerë të cilën ne si shoqëri me besnikëri ende po e bartim ndër breza e veçanërisht te gjinia femërore, të cilat rrallë mund të zhvillojnë personalitetin e tyre pa komplekse dhe ndjenja faji.

Kjo, ndoshta, e arsyeton edhe faktin se gratë, sipas studimeve, preken dy herë më shumë me depresion sesa burrat.

Nga eksperiencia ime profesionale mund të them se gratë, edhe kur gjenden në gjendje depresioni, merakosen se mos, ndoshta, kanë hy në gjynah me dikë e tash po i kthehen.

Supozoj se kjo reflekton në pritjet stereotipike të shoqërisë se si duhet të jenë gratë dhe çfarë roli duhet të luajnë ato.

Sindroma e “vajzës së mirë”, e zbuluar së fundi, konsiderohet e rrezikshme, sepse femrat me këtë sindromë, kur devijojnë nga sjellja tipike, ndihen fajtores ose kanë frikë nga paragjykimet.

Harrojnë se të hysh në gjynah me veten është mëkati më i madh. Sepse, kur ne nuk e duam veten, nuk kujdesemi për veten, e sidomos atëherë kur e ndjejmë shpirtërisht se diçka nuk po shkon me mirëqenien tonë dhe e vetmja gjë që ne bëjmë vazhdojmë t’i ndrydhim ndjenjat tona, atëherë mund të jetë edhe sfida bekim e jo mallkim.

Mos harro se ndonjëherë duhet të vuash në jetë. Jo sepse ke hyrë në gjynah, por sepse nuk e dije se ku dhe kur të ndaloje së qenit e mirë vetëm për të tjerët.

Të ndryshosh sjelljet, që ke mësuar gjatë gjithë jetës tënde për të qenë e mirë vetëm për të tjerët, nuk është e lehtë, por përpjekja ia vlen, veçanërisht kur rritë fëmijët tu.

Shkëndije Pacolli



PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG
Shkëndije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirges



BOOM

**“Beauty Lil”,
klinika estetike
më e njohur në Zvicër,
shqiptarja e famshme
bën nam**

"Beauty Lil", klinika estetike më e njohur në Zvicër, shqiptarja e famshme bën nam



Vlora Kuc, e njohur si Lil Vlora, dikur ishte një nga reperet më sensacionale të industrisë, që sjell frymë avangarde në botën e muzikës. E tash, të gjithë e njohin si një grua të fortë në biznes dhe profesioniste të dëshmuar në fushën e estetikës... Në "Boom" flasim gjëra "boom"...

Prej vitesh jeni në botën e estetikës. Cila është formula e suksesit?

- Është puna e realizuar me dashuri, korrektësi e, mbi të gjitha, me profesionalizëm. U kushtoj rëndësi detajeve, nuk shpërfill asgjë dhe krejt kjo ka rezultuar me sukses.

Diçka që të bënë speciale në fushën e estetikës?

- Punoj me përkushtim, duke synuar ruajtjen e natyralitetit në çdo fytyrë. Nuk më pëlqen t'i nxjerrë njerëzit jashtë vetes.

Cila është ndërhyrja më e kërkuar në klinikën tuaj?

- "Fullface". Pra, komplet fytyrë. Kur ndërhyhet dhe korrektohet në të gjitha pjesët e fytyrës, atëherë

rezultati është i dukshëm dhe mbresëlënës.

A ka edhe meshkuj të cilët vijnë në klinikën tuaj?

- Po, në klinikën tonë vijnë edhe meshkuj, të cilët duan të duken më bukur, më freskët e më rinor. Ose, thënë më mirë, "pëlqejnë ta mbajnë veten".

Çfarë ndërhyrjesh bëjnë meshkujt?

- Varet, edhe pse kryeson korrektimi i hundës me filler dhe mbushja ndër sy.

Komenti më i shpeshtë që e bëjnë klientet tuaja duke dalë nga klinika estetike?

- "Wow"! Kjo është fjala që e dëgjoj më së shpeshti. Falënderojnë pafund.

Ju dukeni shumë bukur. A bëni ndërhyrje?

- Aty-këtu, nga pak...

Botën e estetikës nuk e kam veç punë, por edhe pasion, andaj shpesh përfshihem edhe vetë në ndërhyrje, pa e tepruar, duke ruajtur imazhin tim identifikues.

A kërkojnë të duken si ju?

- Nëse them po, më duket që tingëlloj si mendjemadhe.

Ama, realisht, vijmë dhe kërkojnë që disa gjëra t'i kenë siç i kam unë.

Gjithsesi, ne nuk realizojmë kopje, pasi secili njeri e ka autonominë e fytyrës dhe tiparet e veçanta.

Cila është kërkesa më e çuditshme që ju është bërë nga klientet?

- Thonë: A po ma bën gjoksin me hylaron!

Një koment për punën që bëhet në Kosovë?

- Mendoj se është ok!

A mendon se po tepronet me filler dhe botox në Kosovë?

- Nuk mund të flas në përgjithësi. Nuk e njoh edhe aq mirë tregun në Kosovë.

Një është e sigurt: kudo po intervenohet, meqë njerëzit gjithandej janë në kërkim të pamjes ideale.

Një emër publik te e cila do ndërhyje personalisht?

- Kylie Jennerit ia kisha rregulluar buzët, që deri më tani nuk arriti t'ia rregulloj askush!

A mendon se edhe meshkujt e estradës bëjnë ndërhyrje me botox dhe filler?

- Po, 90 për qind prej tyre bëjnë ndërhyrje me botox dhe filler.

A ke klientë shqiptarë?

- Kam shumë dhe më bëhet qejfi për këtë gjë.

A do t'i kthehesh muzikës?

- Nuk i dihet asnjëherë...

Reperja numër një sipas teje?

- Nicki Minaj.

Për fund?

- Faleminderit që e ndiqni rrugëtimin tim: dikur atë muzikor e sot të fushës së bukurisë dhe estetikës!

Nderim Neziri



Skenat shqiptare *me histori dashurie*

MUZIKA I BASHKOI VENERA LUMANIN E LIND ISLAMIN

Dashuria e tyre për muzikën sollën edhe dashurinë për njëri-tjetrin. Venera Lumani dhe Lind Islami janë njohur gjatë kompeticionit "The Voice of Albania", ku Venera u shpall fituese.

Jetojnë në Tiranë dhe vijojejnë të merren me muzikë. Kanë edhe bashkëpunime me njëri-tjetrin.



ÇIFTI ROMANTIK: MIRIAM CANI E ALBAN SKËNDERAJ

Të dy këngëtarë, të dy mjaft të njohur dhe të dy shumë të dashuruar me njëri-tjetrin.

Alban Skënderaj dhe Miriam Cani janë një nga çiftet më romantik të shou-bizit.

Ata kanë sjellë në jetë edhe dy fëmijë, që janë dashuria e tyre e madhe dhe motivi i jetës për ta.



KËRCIMI I BASHKOI VESA LUMËN E BIG BASTËN

Nuk ishte muzika që i bashkoi çiftin e njohur Big Basta dhe Vesa Luma, por kërcimi! Ata u njohën më mirë me njëri-tjetrin gjatë pjesëmarrjes së tyre në spektaklin "Dancing With The Stars", ku edhe u dashuruan. Çifti e kanë kurorëzuar në martesë dashurinë e tyre dhe janë prindër të Lianit simpatik.

Këngëtarët që u martuan më shumë se një herë

Studimet tregojnë se 45 për qind e martesave të para janë të destinuara të dështojnë.

Studimi thotë : “Çiftet nuk shkojnë drejt martesës së dytë pa u menduar mirë, por i peshojnë mirë të mirat e të këqijat”.

Se janë martuar më shumë se një herë ka shumë njerëz, e ndër këngëtarët tanë, veç të tjerëve, janë: Sabri Fejzullahu, Gena, Genc Prelvukaj, e të tjerë...



SABRI FEJZULLAHU

Sabriu ka qenë i martuar me një tjetër grua, me të cilën ka dy fëmijë. Më pas ai u martua me bashkëshorten që e ka tash, Nerën, me të cilën, gjithashtu, i

GENA

Dy herë është martuar edhe këngëtari shumë i dashur për publikun, Gena. Martesa e tij e parë ka ndodhur shumë vjet më parë dhe nga ajo martesë Gena i ka dy vajza. Ai tash është i martuar me Lorenen, me të cilën ka rënë në dashuri në shikim të parë.



GENC PRELVUKAJ

Këngëtari shumë i njohur, Genc Prelvukaj, para shumë vjetësh ka qenë i martuar dhe nga ajo martesë është djali, Gjini, tashmë i rritur.

Genci më pas u kurorëzua me Eni Koçin, edhe pse diferenca e tyre në moshë ishte bukur e madhe, 15 vjet.

Por, kjo nuk i ka penguar dyshen të jenë bashkë, përkundër faktit që mund të ketë pasur komente të ndryshme nga njerëzit mbi këtë çështje.

Çifti kanë një vajzë, Adean.



Është bërë modë me e rrahë babën!

Mediet tona janë vërshuar nga kronikat e zeza: “Djali rrah nënën!”, “Djali rrahë babën!”, “Nëna e paraqet të birin në polici për dhunë ndaj saj”, “Nusja e bën vjehrrën për spital!”, e tituj të tjerë...

Kosova më parë nuk ka pasur probleme të tilla si tash: “Djali rrahë babën!”, “Djali rrahë nënën!”, “Nëna e paraqet të birin në polici për dhunë ndaj saj”, “Nusja e bën vjehrrën për spital!”, e të tjera.

Në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare ka pasur nder, fytyrë, mëshirë, e veçmas respekt ndaj prindërve.

Kur isha fëmijë, ai që ishte më i vjetër kishte të drejtë t’i kërkonte vëllait më të ri, apo ndonjë anëtarë tjetër të familjes, një gotë ujë.

Fëmija nuk ishte adet t’ia kthente fjalën prindit.

Ai kishte për ta dëgjuar fjalën e tij dhe kaq ishte kjo punë...

DISA NJERËZVE AS KURBANI NUK U NDIHMON!

Para pak ditësh, në një ndejë, një kushëri imi i tregonte një miku se si po vuan nga sëmundja një dajë i babait të tij. “E ka përfshirë sëmundja e keqe, qoftë larg

këtues”, thoshte kushëri për ta qar deri në fund tregimin: “Mos pyet, edhe trupi i është tharë, sepse ka mbetur qe sa vjet ratë.

la kanë blerë shtratin rrotullues djemtë në Zvicër, por nuk po i ndihmon.

I është zvogëluar edhe koka. Nuk po dinë çka të bëjnë me të...

Dikush u kishte thënë t’ia prenë një kurban dhe të drejtohet dikah...

Por, kur ishte i ri nuk ka qenë i rehatshëm.

Kurrë nuk ka ditur me nderua babën e as nënën. Nuk ka bërë asgjë të mirë për askënd, andaj tash Zoti po e dënon me vuajtje!”, e përmbyllin këtë muhabet.

BËRE PUNËN ME VDEKUR KOLLAJ...

Dhe, teksa i dëgjoja kah flisnin, mendja më shkoi te fëmijëria e hershme, kur halla tregonte si kishte vdekur babai i saj.

“Baba pak para se të vdiste ishte ratë nën hijen e “Dardhës Ukere”.

Dhe, qysh kemi qenë duke ndenjor, baba më tha:

“Qohu Resime e po hyjmë brenda se më ka ardhur iza prej Zotit!”.

“Jo, babë, i fortë je!”, i thashë.

“Qohu e të hallashtisem me dardhën dhe me të gjithë juve!”, ma ktheu.

“Jo, babë, nuk është kollaj me e dorëzua shpirtin?!”, ia ktheva.

“Eh, po vdes kollaj se gjatë tërë jetës kam dhënë sa kam pasur mundësi. I kam rritë tre palë jetimë”, ma ktheu.

“Dhe, fill dha shpirt!”, tregonte halla.

DIKUR NUK KA PASUR SËMUNDJE SI TASH...

“Nuk ka pasur sëmundje dikur. Nuk ka pasur as mjekësi si tash, por njerëzit janë shëruar kush si ka mundur...

E sot, me gjithë këtë mjekësi të zhvilluar, vdesin njerëzit duke e trishtuar rrethin familjar, madje edhe më larg!

Vdesin në fatkeqësi të ndryshme, herë-herë shumë të rënda, madje edhe në aso që s’ta merr mendja!

Burim Bajrami



allure.
BEAUTY

Morpheus Fytyre


~~450€~~
300€



Dhuratë:

1 Mezoterapi Lifting

1 Resting Peel





Cili vend i Kosovës quhet “Qyteti i dashurisë”?

Prizreni është ëndrra e shumë të rinjve të Kosovës. Pse?

Në Prizren ka vende për argëtim të të rinjve më shumë se kudo tjetër në Kosovë.

Qendra e qytetit të Shatërvani, te Kalaja e Prizrenit, Marashi, gryka e maleve të Sharrit, pjesa rreth “Lumbardhit”, Vërmica e shumë vende të tjera të Prizrenit dhe rrethinës, janë vende ideale për të shijuar dashurinë.

Në Prizren shumë poetë e këngëtarë

kanë gjetur frymëzimin, të cilët edhe kanë thurur vargje e kënduar shumë këngë...

Pse?

Sepse, vendi të Marashi ka natyrë shumë tërheqëse për të dashuruarit, andaj kudo has çifte të përqaftuar ose kapur dorë për dore.

Por, edhe Kalaja e qytetit të Vërmica janë vende shumë të preferuara për të rinjtë, ku çiftet mund të gjejnë

qetësinë e preferuar.

Andaj, me të drejtë, Prizrenin e quajnë “Qyteti i dashurisë”.

Kështu, nuk është e habitshme pse shkollarët e shkollave të Kosovës në fund të vitit shkollor ekskursionet i bëjnë mu në Prizren, e që, pa dyshim, ia vlen të vizitohet, meqë ka vende me bukuri të rrallë, pa hyrë në detajet e monumenteve historike, e që ka çka të vizitohet.

Nuk po iu ditke jetës...

I dashuri i parë më shkatërroi, i dyti ma shndriti jetën!

Gjithmonë kam besuar se asgjë nuk ndodh pa një arsye dhe se gjithçka që ndodh është orkestrim për të na çuar në një vend të caktuar e në njerëz të caktuar...

Kur isha 21 vjeçe njoha një njeri, i cili ishte komplet i gabuar për mua.

Ajo lidhje zgjati pak muaj dhe ishte një "gabim" i vërtetë, madje më i madhi që kam bërë ndonjëherë, por shqyr Zotit kaloi pa pasoja.

Ishte një gabim që kisha nevojë ta bëja, për të kuptuar shumë gjëra pastaj.

Ishte një lidhje pa lidhje, nga ato me ndarje e pajtime...

NË DITËN QË U NDAVA NGA I DASHURI, MË ERDHI NJË SMS!

Në ditën që u grindëm shumë, e që pasoi me ndarje, me sytë e ënjtur nga të qarit, pashë kur më erdhi një sms në telefon, nga dikush që, siç shkruante, më kishte në

qejf dhe shprehte dëshirën t'më takonte... Mirëpo, e injorova, meqë shpirtin e kisha të lënduar nga ndarja, sepse më ishte thyer zemra.

Dhe, pas një kohe u pajtova sërish me të dashurin e atëhershëm dhe, kështu, vazhduam edhe nja 5-6 muaj, derisa vura gishtin në kokë dhe i dhashë fund njëherë e përgjithmonë...

NJË VIT PAS MESAZHIT...

Për çudi, një vit pasi mora mesazhin nga ai që më kishte shkruar në ditën kur u ndava nga i dashuri, e takova atë njeri, në saje të këmbënguljeve të tij të pareshtura.

Dhe, për çudi, mu në takimin e parë më pëlqeu: fliste rrjedhshëm, me koncept, e jo ta lëshonte kosën të kositë çka do gjë hasë

para vetes...

E, ajo që ishte e shkruar të ndodhë edhe po ndodhke. Po ndodhke dhe pikë, sepse, sado që të luftosh, fati ishte më i fuqishëm se ti!

Dhe, pas asaj ndeje pasuan edhe ndeja të tjera dhe u dashuruam.

Çdo gjë ndodhi natyrshëm.

Ishte gjëja më e lehtë që kam bërë ndonjëherë në jetën time.

Madje, edhe vendimi për t'u fejuar erdhi natyrshëm, ishte i të dyve dhe ndodhi.

Dita kur bëmë fejesën ishte dita më e bukur në jetën time, më e paharruara. U ndjeva e bekuar...

Dhe, po atë verë edhe u martuam.

Me kohë krijuam familjen, që sot e gëzojmë bashkë.

Elvana, Ferizaj

Nuse në shtëpinë e një të çmenduri!

Si vajzë fshati isha xheloze kur dëgjoja se ndonjë shoqe imja kishte gjetur të dashur, apo ikte pa pëlqimin e familjes te i dashuri i saj dhe martohej...

Unë, si vajzë fshati, sa herë dilja në qytet edhe kthehesha vetëm, meqë askush nuk më fliste, e lëre më t'më ngacmonte. Sa e sa herë kur dilja në qytet, për të kaluar ditën, hyrja në ndonjë lokal kozmetike dhe i shikoja gjësendet, por nuk blija gjë, ose hyja në ndonjë butik dhe i shikoja veshjet dhe me duar në xhepa dilja nga butiku...

BËHESHA SIKUR NUK I DOJA VARDISJET E MESHKUJVE!

Më e keqja në familjen time ishte se të gjithë mendonin se daljet e mia të çdoditshme në qytet ishin me pretekst, se kisha ta dashur.

E, unë, as që kisha pasur e as që kisha mashkull që më afrohej...

Megjithatë, duke qenë e rregullt në qytet, një ditë pashë një mashkull shtatgjatë, truphollë dhe i veshur me elegancë teksa

vinte pas meje kudo që hyja unë. Një ditë, në një qoshe të rrugës, më kapi për krahu e më tha: "Tërë kohën jam duke të përcjellë. A mund të pimë kafe bashkë?". Dhe, në vend të përgjigjes, e di se sytë m'u mjegulluan dhe të rrahurat e forta në zemër nisën të më shtoheshin... E, ai e kuptoi shqetësimin tim dhe pa ma lëshuar krahun, u nisëm drejt një restoranti që shihej me sy disa metra më larg...

E PARAQITJA VETEN HIJERËNDË!

Dhe, kur hymë brenda në lokal e u ulëm në një qosh të tij, me duar i largova flokët që më binin mbi sy dhe nisa të bëhesha një vajzë me pamje hijerëndë, serioze. Por, as ai nuk linte gjë mangut, mundahej të bëhej serioz, me ndonjë batutë që e fliste herë pas herë kur e lypte nevoja, momenti...

E, kur u ngritëm, në të dalë të restorantit, ia zgjata dorën që t'i them "mirupafshim".

Por, nuk më la të flisja, meqë shpejt më puthi në buzë.

E, puthja e tij nuk m'u duk se ishte puthje, por një flakë që ma përshkoi tërë trupin.

Dhe, ç'ndodhi pastaj?

Çdo ditë takoheshim po në të njëjtin restorant, në të njëjtin qosh.

E, miqësia jonë sa vinte e shtohej çdo ditë...

Në anën tjetër, në familje hetuan se kisha ndryshuar, se sa herë që dilja në qytet më parë pispilloshesha mirë, vishesha mirë, krihesha mirë...

ATJE KU U MARTOVA GJETA ÇMENDURI!

Edhe pse i dashuri im bënte herë-herë veprime prej një të krisuri, duhej të rrezikoja, në të kundërtën do më shkelte koha...

Dhe, ashtu edhe ndodhi...

Gjashtë muaj pas takimeve të çdoditshme, pa dasmë u bëra nuse në shtëpinë e tij.

Por, fatkeqësisht, të nesërmen, në ditën e dytë të martesës, e kuptova se ajo familje nuk ishte për mua, meqë anëtarët e familjes së saj nisën të grindeshin ndërmjet veti, aq sa krisën edhe grushtet...

E, në atë tollovi, motra e tij, Mina, më rroku për flokësh dhe grushti iu mbush me flokët e mi.

Unë, që t'i ikja më të keqes, ika me vrap në dhomën time dhe derën e kyça me çelës.

Nuk ia hapja derën as burrit, ani pse ai trokiste në derë pa ndërprerje...

Dhe, ditë pas ditësh e muaj pas muajsh, 10 vjet u bënë që jetoj në atë shtëpi me njerëz të çmendur, sepse tash m'i kanë lidhë "këmbët" dy vajzat e mia binjake, të cilat sivjet kanë nisur të shkojnë në shkollë, e që i qoj e i marrë vet...

Sidrita, Viti

AUTO
ALBERTI



 /autosallonialberti

Kontakti: + 383 49 373 373
Email: autosallonialberti@hotmail.com

Unë, dallaverxhiu...

Si e mashtrova gruan e martuar?

Njohja jonë ndodhi në komunë, menjëherë pas lufte, teksa prisnim t'i dorëzonim dokumentet e udhëtimit. I thashë se kisha ardhur për pushim nga Anglia, se isha i pamartuar. E, ajo më besoi...

E vetmja dëshirë imja asaj vere të dytë pas lufte ishte të rregulloja dokumentin e udhëtimit, sepse ai që e kisha nga regjimi serb i kishte kaluar afati. Dhe, në atë tollovi të padurueshme në korridorin e komunës, pranë meje priste një femër e bukur, rreth 35 vjeçe, veshur hollë e bukur. Më tha se e kishte burrin në Gjermani, por që ende nuk e kishte rregulluar leje qëndrimin, që ta merrte me vete. I thashë unë kam leje qëndrimi në Angli dhe mund ta ndihmoja që të shkonte në Gjermani... Madje, kur i thashë se nuk jam as i martuar, iu bë qejfi dhe gati sa nuk më puthi në mesin e gjithë asaj turme... Dhe, biseda jonë u zgjerua duke kritikuar punën e ngathtë të komunarëve,

të cilët tërë ditën na lanë duke pritur në rend, që të afroshim te sporteli...

DOLËM PËR NJË KAFE E PËRFUNDUAM NË BANESË!

Atë ditë, pasi i dorëzuam dokumentet, meqë unë isha para saj, e prita tek kreu punë.

I thashë: "Një kafe do na i qetësonte nervat!"

Ma ktheu: "Mirë do ishte!"

Dhe, mu këto fjalë bën që ne të ndalemi në kafenenë përballë komunës, që vetëm rruga ndodhej ndërmjet.

E, ajo që më la mbresë të jashtëzakonshme ishte përshtypja se si ajo, pa më njohur fare, nisi t'më tregonte për jetën e saj, martesën para 10 vjetësh, shkuarjen e burrit të saj në Gjermani

dhe komunikimi i tyre vetëm nëpërmjet telefonit...

Dhe, kur mendova se është koha të ngrihem, më tha: "Shkojmë në banesën time për nga një gotë verë!". U hutova... I pohova me kokë – po.

MOS U MARTO ME MUA, VETËM MË MERR ME VETE!

E, kur hymë në banesën e saj, teksa i solli gotat me verë, më tha: "Ti vetëm më merr me vete e me u martua me mua s'ke nevojë!".

Por, në vend të përgjigjes, iu afro afër, e rroka për beli dhe e shtrëngova për trupin tim.

Buzët e saj zjarr ma turbulluan mendjen dhe i thashë "po".

E, Emini, Angli

Një hapësirë që flet
dashuri dhe rehati!

Lagjja Panorama

FERIZAJ



Lagjja Panorama
Ferizaj

+383 49 533 999



I dashuri më doli gej!

Në shumicën e rasteve “Facebookun” e hapja nga telefoni dhe, në një rast, më vjen një “friend request” me emrin “Gangsteri”. Por, nuk ma tërhoqi vëmendjen dhe e lashë pezull...

Në ditën tjetër hyra në profilin e tij dhe ç’të shohësh, një kapadai se jo mahi: i pispillosur mirë, veturë të mirë. Mendova: “Gangster” më! Zoti e di me çka merret! Apo qenka tip që mundohet me një veturë të bukur t’i mashtrojë femrat?!

SA DOJA T’MË SHKRUANTE!

Në ditën tjetër ai postoi në profilin e tij një ndejë me shokë.

Dhe, në shpirt më lëvizi diçka nga brenda, një kureshtje që më shtyu me forcë drejt së panjohurës...

Pra, me shpirt e pranova dhe mezi prisja t’më shkruante.

Por, për çudi, kaluan disa ditë dhe ai më nuk u ndie i gjallë!

Mirëpo, pas nja dhjetë ditësh, u zgjua nga gjumi. Më erdhi një “Hi” në “inbox”.

Kjo bëri që diçka edhe më shumë t’më xigëlonte nga brenda, ndoshta edhe nga fakti se ai nuk fliste shumë për veten dhe gjërat që e rrethonin.

Në këtë fazë të komunikimit edhe i shkëm-

byem numrat e telefonit dhe në çast më thirri.

Dhe, sado që të jem modeste, më pëlqeu zëri i tij...

TAKIMI I SHUMËPRITUR NDODHI NË SHI!

Pas një javë bisedash e lamë të takohemi “Te shatërvani”, në qendër të Prizrenit.

Ai do vinte nga Gjakova, nga edhe më thoshte se ishte.

Atë ditë binte një shi i imtë, shi rigash, shi i përshtatshëm për takim të parë.

E, para se të ndaheshim për atë ditë, lehtë më puthi në faqe dhe një e dridhur e fortë ma përshkoi trupin...

Pas një jave u takuam po në të njëjtin vend.

Dhe, në shenjë se e kishte marrë malli, vetëm m’i ledhatoi flokët!

E, në mbrëmje, kur erdha në shtëpi, ndodhi ajo që as nuk e mendja kurrë.

Më erdhi një mesazh nga ai me tekstin: “Nuk mund ta vazhdoj këtë lidhje me ty, më fal!”.

Në çast, m’u dridh toka nën këmbë.

E ndjeva veten të nënçmuar, sidomos kur m’u kujtuan gjithë ata meshkuj që më vardiseshin e unë i refuzoja një nga një...

Megjithatë, këmbëngula për një sqarim: Pse vendosi kështu?!

Dhe, si përfundim, nuk e ndërpreme lidhjen plotësisht, por herë-herë i shkruanim njëri-tjetrit sa për sy e faqe.

Thënë të drejtën, isha e interesuar të dija arsyen pse donte të largohej prej meje...

Dhe, pas nja 5 muaj zhagjitje, më tha: “Nuk jam për ty! Unë jam gej. Më fal!” dhe ma bëri “bllok”.

DITË PAS DITËSH - VETËM VENITESHA...

Pas atij mesazhi u ndjeva edhe më e zhvlerësuar! Kalova periudhën më të vështirë ndonjëherë, sepse, edhe pse nuk zgjati shumë si lidhje, kisha rënë në dashuri.

U përpoqa të dilja me djem të tjerë sa për muhabet...

V. A.



Revolucion në DOBËSIM

E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë. Rugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë. Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm. Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përbushur ëndrrat e tyre.



Perforco
vaten



Detoksifikohu



Relaksohu



Balanco
Shëndetin



PARA



PAS



PARA



PAS



PARA



PAS

Prishtinë

+383 45 224 540

Prizren

+383 43 900 902

Gjilan

+383 45 505 043

Gjakovë

+383 44 545 444

Dashuri si në telenovela...

Askush s'ka *buzëqeshje* si ajo!



Dashuria ime u zhvillua si në telenovela! Gjithçka lindi nga një shikim. E, nuk thonë kot se në qoftë se shikon dikë në sy për më shumë se 2 sekonda, e ke “hëngër”!

Ajo që më bëri më shumë përshtypje në shikim të parë ishte buzëqeshja e saj. Asaj i qeshnin buzët. E, bashkë me buzët edhe sytë. Pra, ishte nga ato femra që çdokush dëshiron ta ketë pranë, nga ato femra që presin dhe ëndërrojnë princin e kaltër, nga ato ferma që s'bëhen dy... Por, e keqja ishte se shoku im i ngushtë, kishte vite që e ngacmonte, andaj edhe nuk mund t'i vardisesha. Mirëpo, ajo me kohë e kuptoi që e pëlqej dhe e bëri hapin e parë.

E, SI NDODHI HAPI I PARË?

Një ditë në telefon më shkroi: Të dua! Dhe, në çast dola nga shtëpia me vrap për në lagjen e saj. E dija se në atë kohë ajo nisej të shkonte për në dyqanin ku punonte dhe, pa dyshim, do e takoja në rrugë. Por, për çudi, nuk doli edhe pas një orë pritjeje! Atëherë, i shkrova: “Jam duke të pritur në fund të lagjes”. Dhe, nuk vonoi shumë kur e pashë tek

vinte në drejtim timin...

Kur u afrua, ma zgjati dorën dhe buzëqeshi si zakonisht. E, buzëqeshja e saj ma turbulloi mendjen dhe e putha me afsh! Le të del ku të del, e solla në mendje.

SI I PROPOZOVA MARTESË?

Tash, nga ajo puthje, kanë kaluar hiq më pak se dy vjet. Dhe, në këtë përvjetor të puthjes sonë i propozova martesë...

Durimi, Klinë

25 për qind e grave tradhtojnë!

Tradhtia në jetën bashkëshortore është njëri prej shkaqeve kryesore në ndarjet që ndodhin në ditët e sotme.

Pra, faktori më i rëndësishëm i “ekskursionit” jashtëbashkëshortor është kur njëri prej bashkëshortëve hidhet në krahët e partnerit të tretë...

Në kohët e kaluara tradhtia është dënuar edhe me masat më drastike.

Por, a ndodh sot kështu?

Koha jonë i ka veçoritë e veta. Çdonjëri është i lirë të vendosë të jetë besnik ndaj partnerit të vet apo jo, pavarësisht nga mendimi i tij i vullnetshëm për të krijuar lidhje bashkëshortore, që bazohen në ligjin për bashkëshortësi.

A KANË MESHKUJT A FEMRAT

JETË MË INTENSIVE?

Statistikat tregojnë se meshkujt kanë numër më të madh të partnerëve seksualë dhe se i ndërrojnë më shpesh.

Andaj, ky intensitet i shprehur, në esencë, tregon për intimitetin e zvogëluar emocional dhe psikologjik të mashkullit. Pra,

nevojat seksuale të mashkullit nuk identifikohen me ndjenjat e dashurisë.

Hulumtimet shkencore tregojnë se më shumë se 50 për qind e meshkujve, që kanë kontakte seksuale me femra jashtë martese, e bëjnë atë për nevoja të veta momentale trupore.

E, te femrat janë më të shprehura nevojat emocionale.

Reaksionet e femrës kur sheh një mashkull të zhveshur janë më të vogla sesa kur mashkulli sheh një femër pa rroba, sepse skenat erotike shkaktojnë përndezje të 84 për qind të meshkujve, e të femrave 25 për qind.

Ç'THONË PSIKOLOGËT?

Psikologët kanë konstatuar se meshkujt më shumë tradhtojnë, meqë janë persona më të hapur, më komunikativë, energjikë

dhe dinamikë.

Jeta e tyre seksuale fillon herët dhe nga viti në vit është më intensive...

Sidoqoftë, femrat i japin më shumë hapësirë paralojës seksuale, stimulimeve, karshi meshkujve, të cilët kanë dëshirë të kryejnë punë sa më shpejt që të jetë e mundur...

CILËT JANË MË STABILË - MESHKUJT A FEMRAT?

Marrëdhënien më stabile seksuale e kanë tipat e përmbajtur, edhe pse raportet janë shpesh të përcjella me probleme dhe vështirësi të caktuara.

Andaj, kjo është edhe arsyeja pse ata rrallë edhe tradhtojnë.

Por, edhe nëse u ndodhë të tradhtojnë, ose lidhen me partnerin e ri, ose pendojnë thëllësisht për tradhtinë dhe fajin që e kanë bërë...

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Jam në kolaps jetësor!

Përshëndetje! Jam grua e martuar qe 5 vjet, nuk kam fëmijë. Mërzitem shumë që jam në këtë gjendje.

Shkova te mjeku. Më tha je e sëmurë nga mushkëritë. Më dha terapi dhe u shërova. E, pse nuk po mbes shtatzënë, më thonë se është pak moshë në pyetje dhe duhet të bësh shtatzëni artificiale.

Por, unë nuk i kam kushtet për këtë proces, sepse kushton shumë.

Çka të bëj tutje?

Të lutem, më jep një përgjigje se jam në udhëkryq e nuk po di si ta gjej rrugën e jetës...

“Pa shifër”

Përgjigje:

Ti ke komplikime me burrin dhe probleme me atë familje.

Kjo është arsyeja e parë që ti nuk ke shtatzëni.

Do të thotë te ti dominon stresi e frika e përditshme dhe mendimi se çka do të ndodhë nëse ti ndahesh...

A do të kalojë ndarja juaj pa ndonjë problem të rëndë, si të kërcënon familja e burrit apo duhet të ndahesh si të preferon familja jote, je ndërmjet dilemave...

Sugjerimi im është ta përfillësh mendimin e familjes tënde, sepse

ata janë të vetmit që ndiejnë për ty dhimbje, ndërsa familja ku je ti të shikojnë si shërbëtore!

Magji apo epilepsi?

Jam 30-vjeçar, jetoj në SHBA. Para tre vjetësh kisha një reagim pa ndjenja dhe kisha pështymë e kafshim gjuhe e dridhje. Mjekët më thanë epilepsi.

Në Kosovë më thanë se kam magji.

Si të them, pak më është qetësuar problemi, por më përsëritet akoma.

Çka më thua ti, cili është problemi?

“S., SHBA”

Përgjigje:

Në fakt, përjetimi yt më shumë ngjason me epilepsi sesa me magji.

Dhe, kur ekziston diagnostifikimi i mjekësisë amerikane, më nuk mbetën teza për komente.

Por, ka disa gjëra të cilat lidhen me dyshime të tjera.

Pikë së pari, sikur të ishte krejtësisht epilepsi, ti do të ishe shëruar me terapi.

Vazhdo të kërkosh shërimin, sepse nuk dihet ku e gjen njeriu atë.

Në çdo rast, kur mjekësia serioze jep diagnozë dhe version shërimi, kjo do të ishte plotësisht në rregull për ta besuar dhe për të kërkuar shërimin.

Por, nëse edhe mjekësia nuk të sjellë shërimin, atëherë gjërat qëndrojnë më ndryshe.

Pra, besoni në mjekësi, por mos i harroni edhe mundësitë tjera alternative, sepse ndonjëherë një fjalë shëron më shumë se një ampulë.

A ka grua për mua?

Jam 42 vjeç, i pamartuar.

A thua kam edhe unë fat të martohem apo realisht kam të bëra sikur më thonë?

Kam pasur disa oferta për martesë, por më kanë dështuar. Së fundi, jam në shkëmbim me-sazhesh me një femër, por nuk di a është fati im...

“42-vjeçari nga Vushtrria”

Përgjigje:

“Kush e kërkon fatin e vet edhe e gjen. Mos e kërko të huajin!”, thotë populli.

Por, këtu duhet kuptuar atë që është për ty e që është rang yti. Shoh se deri në fund të vitit do të vjen fati për martesë, do të bësh zgjidhje...

Pse gruaja ime është në depresion?

Jam nga Gjilani, 45-vjeçar. Gruaja ime ka rënë në depresion. Nuk di arsyen.

Kemi fëmijë.

Çka është në pyetje, të lutem?

“Burri i brengosur”

Përgjigje:

Depresionit i paraprijnë shumë faktorë, të cilët e përrulin njeriun shëndetësisht, por zakonisht stresi depresiv nuk është i bazës medicinale.

Ai ka gjenezë të ndryshme, që njerëzit e kanë hulumtuar prej kohësh, por pa sukses apo me pak sukses.

Depresioni i disa rasteve nuk

mund të shpjegohet në shumë raste, sepse është në masë të madhe problem që kushtëzohet nga specifikitetet psiko-sociale familjare dhe nga e kaluara konservatore, pastaj nga pakënaqësitë e rastit që mund të krijojë martesë, por edhe nga problemet që mund të sjellë burri, i cili nuk e përfillë gruan...

Ti ke shumë udhëtime dhe nuk të shoqëron bashkëshortja në asnjë rast.

Pastaj, thashethemet e shumta, të cilat gruan tënde e kanë bërë të pasigurt pranë teje...

E, depresioni nuk shërohet vetëm me barëra, por më shumë me sjellje të mirë...

Më do apo nuk më do burri?

Jam 51-vjeçare, jetoj në Prishtinë. Nuk jam e punësuar, edhe pse e kam kryer fakultetin me notë mesatare 9!

Nuk kam pasur nevojë të punoj, falë jetës së mirë që më ka dhënë Zoti dhe burri.

I kam tre fëmijë.

Me burrë ende shëtisim bashkë, por më duket se nuk po më do sikur më ka dashur më parë.

Të lutem, më jep përgjigje: A ka ndryshuar burri im apo çka është në pyetje?

“Zonja N., Prishtinë”

Përgjigje:

Është një thënie: “Nuk mjafton vetëm të më duash, por edhe të më thuash të dual!”

Megjithatë, ana praktike e tregon anën tjetër të monedhës. Më mirë të funksionojë dashuria dhe lidhja në praktikë, sesa të të thotë se të do deklarativisht!

Ju tashmë keni një moshë, në të cilën fëmijët kanë shumë kërkesa. Andaj, është mirë t’u përkushtoheni fëmijëve, e dashuria juaj do të vijë duke rënë në binarë të vetë...

Pse dështoj kur ndihem mirë?

E dashura magjistare, kam një problem që mendoj se nuk e ka çdo kush: Kur e ndjej veten mirë, them me vete shyqyr Zotit po më ecë mirë gjithçka... Por, shpejt çdo gjë rrënohet, fillon çdo gjë të mbrapshtohet dhe vij në pozitë të them çka po ndodh me mua?!

Thonë fati vjen krejt papritur dhe ashtu më ka ndodhur edhe mua.

E njoha një djalë, me të cilin çdo gjë ecte mirë.

Dhe, gjërat filluan të thellohen, duke shkuar çdo ditë e më mirë. Por, shpejt u ftoh na unë dhe më la me gishta n’gojë!

Kështu, më ndodhi edhe me njohjen e radhës...

Pse sa po filloj mirë me dikë, ndodh diçka që e shkatërron?

“Niset mirë, rrënohet lehtë”

Përgjigje:

Një thënie popullore, e që e ka burimin në përvojën e popullit, thotë: “Mos u gëzo i gëzuar, mos u hidhëro i hidhëruar!”

Kjo fjali e koncepton dhe shpjegon më së miri këtë gjendje të ndryshimeve socio-psikike të njeriut, te i cili ndodh kataklizëm praktik dhe shpirtëror, si në një poezi të arbëreshit Vorea Ujko, i cili për syzhe tematik i ka tri motra që presin fatin.

Dhe, kur e pret e madhja fatin që duhej të vinte në agim, po atë mëngjes vdes papritur.

Edhe motra e dytë njëjtë e kishte kërkuar fatin dhe në vend të fatit i vjen vdekja e befasishme.

E, kur motra e vogël u ndikua nga kjo përvojë, duke pritur vdekjen në vend të fatit, ia beh fati dhe e bëri të lumtur...

Andaj, nisur nga kjo përvojë, pop-

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

ulli e ka thënë urtinë popullore që e përmendëm më lart, e që dëshmon se jo gjithnjë jeta shkon sipas parashikimeve.

Sepse, jeta di të sjellë edhe befasi e surpriza...

Filozofia popullore rrjedh nga përvoja, ashtu sikur janë krijuar këngët popullore në luftë e në mjerim, në tragjedi e në mort. Por, në rastin tënd, ia vlen lufta për atë person që të ka dashur. Sepse, ai që të ka dashur ka mundësi të të dojë sërish...

Çfarë qëllimi ka ish-i dashuri im?

Jam vajzë, 27-vjeçare, jetoj në rrethinën e Ferizajt.

Kam pasur një të dashur, me të cilin kemi qenë bashkë 7 vjet.

Por, ai u martua.

Pasi u martua m’u lajmërua dhe më ka ofruar martesë, duke më premtuar besnikëri.

Jam pa tekst!

T’i besoj apo jo?

“E humbura”

Përgjigje:

Unë kam mendim negativ sa i përket ribashkimit tuaj me martesë. Këshilla ime është ta gjes fatin tënd. Mund të ndodhin shumë gjëra të pakëndshme nëse ju lidhëni përsëri.

E para, ribashkimi juaj me martesë do të qonte në ndarjen e tij nga gruaja.

E dyta, çrregullimi ndërfamiljar mund të prodhojë situatë që nuk do e dëshironit as ju vetë...

Andaj, kërkoje fatin e ri dhe harroje atë person!



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE